

KMDK. SH.A

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A
KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY LLC
KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DO

Nr. 01/37/11
Dt. 23/10/2020
Prishtinë

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË

PLANI I BIZNESIT 2021 - 2023



KMDK
Tetor 2020

	REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /		
	REPUBLIC OF KOSOVO		
GEVERIA - VLADA - GOVERNMENT			
MINISTRIA E EKONOMISE DHE AMBIENTIT			
MINISTARSTVO EKONOMIJE I ZIVOTNE SREDINE			
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT			
Mjësia Org. Org. Jedin Org Unit	<u>01/3</u>	Nr. Prof. Br. Prof. Prof.No:	<u>1822</u>
Nr. i faqesha Broj strana No. pages		Data: Datum: Date:	<u>23.10.20</u>
PRISHTINE/A		NO.1	

MHA

TABELA E PËRMBAJ TJËS

Përmbajtja.....	1
Figurat.....	3
Tabelat.....	3
Shkurtesat.....	4
1. Hyrje	5
2. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2.1 Deklarata Politike.....	5
2.2 Vizioni.....	6
2.3 Misioni.....	6
3. Historiku i Ndërmarrjës	6
4. Veprimtaria e kompanisë.....	7
5. Kufizimet – Rreziqët	7
5.1 Mos caktimi i lokacionit të deponisë sanitare.....	8
5.2 Mosaprovimi i ngritjes së Tarifës.....	8
5.3 Rreziqet e deponisë sanitare.....	8
5.4 Mungesa e Grandeve dhe Subvencioneve	9
5.5 Amortizimi i Makinerisë.....	9
5.6 Deponitë Ilegale.....	9
5.7 Zhvillimet e Paparashikuara Operative me Kosto Financiare.....	11
5.8 Kontestet Gjyqësore.....	12
5.9 Fatkeqësitë Natyrore.....	12
6. Menaxhimi i Mbeturinave në BE.....	13
7. Menaxhimi i Mbeturinave në Kosovë.....	16
8. Menaxhimi i Mbeturinave – Korniza Ligjore.....	17
8.1 Korniza Ligjore e BE-së.....	17
8.2 Korniza Ligjore e Kosovës.....	17
9. Orientimi Strategjike.....	18
9.1 GAP Analiza.....	18
9.2 Pikat e Forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet – SWOT Analiza.....	18
10. Objektivat.....	19
10.1 Përmirësimi i Afarizmit.....	20
10.2 Ngritja e Kualitetit të Shërbimit Primar, Monitorimit dhe Përmirësimit në Menaxhimin e Qëndrushëm të Deponive	20
10.3 Përmirësimi i Shërbimeve të Aktiviteteve Sekondare.....	20
10.4 Zvogëlimin e Rrezikut në DS	20
10.5 Ndërtimi i Deponive të Reja dhe Zgjerimi i Kapaciteteve Pranuese në DS Aktuale.....	21
10.6 TIK në Menaxhimin e Deponive.....	21

10.7 Ofrimin e Shërbimeve të Reja – Aktivitete Tërciare	21
10.8 Rritja e të hyrave dhe kujdesi racional ndaj shpenzimeve.....	21
10.9 Ngritja e Kapaciteteve Teknike dhe Kujdesi ndaj Aseteve, Pajisjeve të Punës	21
10.9.1 Kujdesi ndaj Aseteve, Pajisjeve të Punës.....	21
11. Ngritja e Kapaciteteve Njerëzore.....	21
11.1 Organogrami.....	22
11.2 Numri i Punëtorëve dhe struktura gjinore.....	23
11.3 Planifikimi i Trajnimit të Stafit.....	24
11.4 Rekrutimi i Stafit.....	24
12. Kapaciteti dhe Mundësitë Potenciale për rritjen e Biznesit.....	24
13. Plani i Analizave Financiare.....	26
14. Deklarata dhe Analiza e të hyrave	32
15. Plani i Investimeve	33
16. Struktura e Buxhetit.....	34

LISTA E FIGURAVE

Figura 1	<i>Deponitë ilegale - të dhënat për vitet 2017 dhe 2019 (fq.11)</i>
Figura 2	<i>Mbeturinat e gjeneruara nga viti 2005 deri në 2018, kg për vend (fq.13)</i>
Figura 3	<i>Hierarkia e menagjimit të mbeturinave në BE (fq.15)</i>
Figura 4	<i>Hierarkia e menagjimit të mbeturinave (fq.19)</i>
Figura 5	<i>Numri i punëtoreve dhe strukutra gjinore (fq.24)</i>
Figura 6	<i>Struktura e buxhetit (fq.36)</i>

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	<i>Deponitë ilegale sipas madhësisë në rajone (2019) (fq.10)</i>
Tabela 2	<i>Deponitë ilegale sipas llojit të mbeturinave në rajone (2019) (fq.10)</i>
Tabela 3	<i>Mbeturinat e gjeneruar nga viti 1995 deri në vitin 2018 për kokë banori (fq.14)</i>
Tabela 4	<i>Sasia e mbeturinave të deponuar në KMDK dhe deponitë tjera në Kosovë 2019 (fq.16)</i>
Tabela 5	<i>Numri i punëtorëve dhe struktura gjinore në KMDK SH.A (fq.23)</i>
Tabela 6	<i>Sasia e mbeturinave nga KRM-të dhe Klientët Privat, për periudhën 2021, 2022 dhe 2023 (fq.25)</i>
Tabela 7	<i>Kalkulimet analitike sipas Deponive Sanitare dhe Statcionit të transferit në Gërllicë-Ferizaj në sasi (ton) bazuar në 9 mujorin e planifikimit dhe realizimit nga viti 2019 (fq.26)</i>
Tabela 8	<i>Raporti i të hyrave në euro nga mbeturinat e amvisërisë (Komunale) për vitin 2017;2018 dhe 2019(fq.27)</i>
Tabela 9	<i>Sasia e mbeturinave nga KRM-të dhe Klientët Privat, për periudhën 2017, 2018 dhe 2019 (fq.27)</i>
Tabela 10	<i>Pasqyra e planifikimit të të hyrave, shpenzimeve dhe amortizimit (shpenzimet e zhvlerësimit) për vitet 2020 (fq.28)</i>
Tabela 11	<i>Pasqyra e planifikimit të të hyrave, shpenzimeve dhe amortizimit (shpenzimet e zhvlerësimit) për vitin 2021-2023 (fq.30)</i>
Tabela 12	<i>Plani i të hyrave nga mbeturinat në ton (fq.33)</i>
Tabela 13	<i>Projektët e propozuara për vitët 2021-2023 (fq.34)</i>
Tabela 14	<i>Struktura e buxhetit (fq.35)</i>
Tabela 15	<i>Investimet kapitale të synuara parapara me bashkëfinancimet e jashtme (fq.37)</i>

1. LISTA E SHKURTESAVE

LNP	Ligji për Ndërmarrje Publike
LM	Ligji për Mbeturina
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
MZHE	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
NJPMNP	Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
ZRRUM	Zyra Rregullatorë për Ujë dhe Mbeturina
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
BD	Bordi i Drejtorëve
KA	Komisioni i Auditimit
KPE	Komiteti për Emergjencë
TIK	Teknologjia Informativë dhe e Komunikimit
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
KRM	Kompanitë Regjionale të Mbeturinave
PB	Plani i Biznesit
DS	Deponitë Sanitare
AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
AMMK	Agjencioni për Menaxhimin e Mbeturinave të Kosovës

1. Hyrje

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë. Shoqëri Aksionare (*shkurtimisht*: KMDK SH.A), është e themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në 2008, ndërsa deri në atë periudhë prej viti 2005-2008 ka funksionuar si Kosovo Landfill Management Company J.S.C, nën ombrellën e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM).

KMDK SH.A, është e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve (*shkurtimisht*: ARBK) si Ndërmarrje Publike me aksionar 100% Qeverinë e Republikës së Kosovës konformë Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe aktivitetin e vet e zhvillon në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, akteve të brendshme juridike si dhe dokumenteve strategjike.

2. Përmbledhje Ekzekutive

Plani i Biznesit është dokument strategjik për funksionimin dhe zhvillimin e Kompanisë për vitet 2021-2023, i cili definon misionin, synimet dhe rezultatet e pritshme.

Plani i Biznesit 2021-2023, bazohet në nenin 17, të Ligjit Nr.04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike pastaj bazohet edhe në kornizën ligjore që ndërlidhet me menaxhimin e sektorit të mbeturinave në nivelin qendror dhe komunal, në veçanti menaxhimin e deponive sanitare.

Plani i Biznesit është i bazuar nga të hyrat vetanake (vetë financuese), por në segmente të caktuara kur ka të bëjë me projekte me vlera të mëdha investuese dhe strategjike kërkon mbështetjen financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për shkak të mos caktimit të tarifës reale të shërbimeve, sipas dispozitave të Ligjit për Mbeturina dhe neni 13.15 pika b e Kodit të Etikës dhe Qeverisjës Korporative për Ndërmarrjet Publike, apo nga donatorë dhe investitorëve potencial.

Plani i biznesit synon planifikimin dhe realizimin afarist financiar të Kompanisë për vitet 2021-2023 duke u bazuar në parametrat sa më real financiar në mes të hyrave dhe shpenzimeve.

Ky Plan i Biznesit është përgatitur nga të dhënat analitike si dhe krahasimet me vitet paraprake, pastaj duke u bazuar në gjendjen aktuale të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive, si dhe duke synuar aplikimin e standardeve dhe praktikave më të mira për të përmbushur qëllimin dhe misionin e Kompanisë për zhvillim të qëndrueshëm.

Ky Plan i Biznesit mund t'i nënshtrohet rishikimit vjetor në bazë të nevojave të Kompanisë, sipas rregullativës juridike.

2.1 Deklarata e politikës

Kompania synon të ofrojë shërbime cilësore duke u përpjekur që:

- të ofrojë siguri dhe qëndrueshmëri financiare.
- të ofrojë qasje transparente në afarizmin e kompanisë.
- të ofrojë zbatueshmëritë e ligjeve në fuqi dhe të Kodit të Etikës për Qeverisjën Korporative.

- të rrisë dhe intensifikojë bashkëpunimin me institucionet relevante, që mbikëqyrin veprimtarinë e kompanisë, si dhe bashkëpunimin me KRM-të dhe klientët tjerë, si dhe me kompanitë simotra në rajon dhe më gjerë.

2.2 Vizioni

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë synon të ndërtojë një sistem të menaxhimit, bazuar në praktikatat e mira, përmes aplikimit të politikave dhe procedurave kualitative si dhe ngritjen e kapaciteteve operative dhe financiare.

Vizioni i kompanisë është i bazuar në këto premisa:

- Intensifikimi i investimeve kapitale që mundëson rritjen e vlerës së aseteve të kompanisë.
- Ndarja, klasifikimi dhe riciklimi i mbeturinave.

2.3 Misioni

Misioni i kompanisë për menaxhimin e deponive sanitare të Kosovës është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga ndotja dhe rreziku nga mbeturinat, përmes administrimit të mbeturinave, duke krijuar kushte për parandalimin dhe zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre.

KMDK do të sigurojë shërbime të sigurta, të besueshme dhe mirë të organizuara të deponive për të gjithë prodhuesit e mbeturinave nga ekonomitë familjare në Kosovë. Kompania do të ofrojë këto shërbime me një organizim të vogël por të fuqishëm. Integrimi i kompanive private në proces të menaxhimit të deponive do të shfrytëzojë opsionin e partneritetit publik – privat duke shfrytëzuar fuqinë dhe lëvizshmërinë e kompanive private për të mirë të palëve të interesit dhe konsumatorëve të KMDK-së. Njëkohësisht duke bërë përpjekje për të siguruar një subjekt financiarisht të vet qëndrueshëm me qëllim që të sigurojë shërbime kualitative në pajtim me Standardet Evropiane.

Qasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe etike, e bazuar në dispozita ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Njësisë monitoruese për Ndërmarrjet Publike, Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimin Hapësinor, Zyrën Rregullative për Ujë dhe Mbeturina dhe akterët tjerë.

3. Historiku i Kompanisë

Kompania është themeluar në vitin 2005 nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, ndërsa deponitë janë ndërtuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (AER).

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH.A.) është e listuar si Ndërmarrje Qendrore Publike me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Plotësim Ndryshimeve të tij dhe është e regjistruar si Shoqëri Aksionare konformë Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, ndërsa aktiviteti i saj i funksionimit dhe i menaxhimit të mbeturinave në Deponitë Sanitare (DS), bazohet në respektimin dhe zbatimin e kritereve të dispozitave relevante ligjore për mjedisin.

Monitorimin, aktivitetin dhe afarizmin e Kompanisë si aset i Qeverisë së Republikës së Kosovës e bën Njësia për Politika dhe Monitorim (NJPNP) në kuadër të Ministrisë Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike konform kornizës për ushtrimin e të drejtës pronësore në Ndërmarrjet Publike dhe rregullave të qeverisjes së korporatave.

4. Veprimtaria e Kompanisë

Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

KMDK si veprimtari primare e ka :

- **3900** Aktivitetet e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbeturinave, veprimtaria primare

Aktivitetet sekondare;

- 3811 Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme,
- 3821 Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme,
- 7511 Veprimtaria e shërbimeve të përgjithshme publike.
- Shërbimi i deponimit të mbeturinave Komunale në Deponitë Sanitare, Regjionale.
- Shërbimi i deponimit të mbeturinave Komunale në Deponitë Sanitare, Regjionale.

Kompania menaxhon me katër (4) deponi dhe një stacion transferi duke ofruar shërbime si në vazhdim:

1. Deponia Sanitare e Mirashit – Prishtinë.
2. Deponia Sanitare e Landovicës – Prizren.
3. Deponia Sanitare e Velekincës – Gjilan.
4. Deponia Sanitare e Dumnicës – Podujevë.
5. Stacionin e Transferit në Gërlicë – Ferizaj.

5. Kufizimet –Rreziqet

Me rastin e hartimit të këtij Plani të Biznesit të KMDK-së në realizimin e objektivave të parapara, duhet të kemi parasysh kufizimin e realizimit të këtyre objektivave nga rreziqet të cilat mund të kufizojnë apo të pengojnë implementimin e ndonjërit nga objektivat e përshkruara në projekt plan.

Kufizimet dhe rreziqet me të cilat mund të ballafaqohet KMDK SH.A në zbatimin e objektivave dhe në realizimin e plotë të këtij plani mund të jenë zhvillimet që mund të ndodhin, faktorët direkt dhe indirekt nga akterët që ndërliken me veprimtarinë e Kompanisë

5.1 Mos caktimi i lokacionit të deponisë sanitare

Mos caktimi i lokacionit për deponi të re sanitare do të sjellë probleme të jashtëzakonshme në aspektin financiar.

5.2 Mos aprovimi i ngritjes së tarifës

Mos aprovimi i ngritjes së tarifës së shërbimit për menaxhim efikas të deponive, tarifa aktuale nuk mbulon shpenzimet operative të trajtimit të mbeturinës për ton.

Tarifa aktuale e përcaktuar nga ZRRUM 5.31€ + TVSH, ka qenë për një periudhë fikse nga 01.06.2012 deri më 31.05.2013, kjo tarifë është e ulët dhe jo reale për shkak se nuk mbulon koston e shpenzimeve për menaxhim për ton mbeturine, prandaj kemi bërë kërkesën për ngritjen e tarifave pranë MZHE-së, si autoritet kompetent për përcaktimin e tyre.

Për mbulimin e koston së trajtimit të mbeturinave, Kompania ka adresuar kërkesat për caktimin dhe ngritjen e tarifave të shërbimeve dhe ka përgatitur raportin e brendshëm analitik të koston së shpenzimeve për ton mbeturine në Deponitë Sanitare (Shih Raportin Nr. 954/2017 të datës 08/12/2017), nga i cili raport është dhënë propozimi për dy zgjidhje opsionale, ku njëri opcion është caktimi i tarifës 25 Euro për ton, kurse opsioni i dytë është 14 Euro për ton kurse pjesa tjetër prej 11Euro, të subvencionohet nga Aksionari sipas kërkesave të nenit 13.15 pika b të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.

KMDK SH.A, do të zbatojë tarifën e caktuar nga MZHE-ja sipas legjislacionit në fuqi. (Ligjit të Mbeturinave dhe Udhëzimit për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave).

Aprovimi i tarifave të reja do të mundësojë:

- qëndrueshmërinë financiare dhe operative të KMDK-së.
- mbulimin e shpenzimeve operative.
- planifikimin dhe realizimin e projekteve për investime kapitale.
- trajtimin e mbeturinave sipas standardeve të kërkuara.
- mbulimin e shpenzimeve në fazën finale të mbylljes dhe monitorimit të deponive.

Caktimi i tarifës reale prej 25 Euro për ton do të mundësojë që KMDK SH.A të menaxhojë në mënyrë adekuate risqet dhe rreziqet e evidentuara në pikën 1.4 dhe 1.5 të këtij PB.

5.3 Rreziqet në deponitë sanitare

Duke përfshirë por mos tu kufizuar:

- Fundosja e deponisë

- Shpërthimi i zjarreve
- Ujërat e zeza

5.4 Mungesa e grandeve dhe subvencioneve

Deponitë sanitare janë para përfundimit të jetëgjatësisë së tyre të përcaktuara nga projektet dhe standardet e Agjencisë Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (AER).

Mungesa e caktimit të lokacionit për ndërtimin e Deponive Sanitare të reja, paraqet rrezik për tërheqjen e investitorëve ndërkombëtarë të cilët janë paraqitur të gatshëm për ndërtimin e DS-ve për Regjionin e Prishtinës. Ndërtimi i DS-ve të reja është barrë e pa përballueshme për KMDK-në njëkohësisht edhe për Qeverinë e Kosovës andaj dhe grandet ndërkombëtare janë shumë të domosdoshme.

Për të arritur standardet Evropiane sa i përket Menaxhimit të Deponive Sanitare është e domosdoshme të bëhen Investime Kapitale milionëshe të cilat janë të pa përballueshme për buxhetin e KMDK-së, andaj mirëpresim grandet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe donatorëve ndërkombëtarë.

Rrezik potencial i cili mund të shkaktojë aksident ekologjik është "liqeni" i krijuar si pasojë e zgjedhjes së gabuar të lokacionit për ndërtimin e kësaj deponie, si dhe nga pamundësia e trajtimit adekuat të lagunës së ujërave të zeza në DS Mirash. KMDK SH.A, këtë rrezik e ka adresuar tek Aksionari dhe presim që me përfundimin e dokumenteve strategjike (Hartimi i Strategjisë për Mbeturina dhe Hartimi i Fizibilitetit me mbështetje nga KFW-Gjermane), ti jepet zgjidhje këtij problemi.

5.5 Amortizimi i makinerisë

Amortizimi i makinerisë paraqet një sfidë operimi. Amortizimi i makinerisë ekzistuese si dhe pamjaftueshmëria e makinerisë së nevojshme për trajtimin e mbeturinave për shkak të sasisë në rritje të mbeturinave të pranura në D.S. Makinaria e vjetër, paraqet kosto të kushtueshme operative dhe kosto të lartë të mirëmbajtjes me rrezikshmëri të ndalimit të punës së tyre të parashikueshme në trajtimin e mbeturinave e cila mund të paraqesë kaos ambiental. Blerja e makinerive të rënda është me kosto jashtëzakonisht të lartë dhe është e pa mundur blerja e të gjitha makinerive të nevojshme nga buxheti i KMDK-së.

5.6 Deponitë Ilegale

Deponitë Ilegale paraqesin sfidë të mundshme të cilat mund të ndikojnë në zvoglimin e sasisë së mbeturinave të deponuara në DS, duke ndikuar në zvogëlimin e të hyrave të parashikuara me Plan të Biznesit.

Në bazë të Raportit të AMMK-së, në 38 Komuna janë identifikuar gjithsej 2,529 deponi ilegale të madhësive të ndryshme, ku dominuese ishin mbeturinat e ndërtim-rrënimt. Ky numër tregon ngritje të shifrës së deponive ilegale (957) në vend, nga viti 2017, kur ishin identifikuar 1,572 deponi. Bazuar në të dhënat nga të gjitha komunat në Kosovë, pjesa më e madhe e deponive janë deponi të mëdha (39%) dhe lloji dominues i mbeturinave në deponi është komunale (46%) dhe mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimt.

Tabela 1. Deponitë ilegale sipas madhësisë në rajone (2019)

	RAJONI	Deponitë ilegale sipas madhësisë			Deponi ilegale gjithsej
		Deponi të vogla (1-5 thasë mbeturinash 200 l)	Deponi të mesme (6-20 thasë mbeturinash 200 l)	Deponi të mëdha (>20 thasë mbeturinash 200 l)	
R1	RAJONI I PRISHTINËS	173	206	203	582
R2	RAJONI I MITROVICËS	74	69	78	221
R3	RAJONII PEJËS	149	108	85	342
R4	RAJONI I PRIZRENIT	76	124	248	448
R5	RAJONI I FERIZAJT	21	33	104	158
R6	RAJONI I GJILANIT	110	118	149	377
R7	RAJONI I GJAKOVËS	19	34	65	118
KOSOVË		622	692	932	2246

Tabela 2. Deponitë ilegale sipas llojit të mbeturinave në rajone (2019)

	RAJONI	Deponitë ilegale sipas fraksioneve				
		Mbeturina komunale	Mbeturina të ndërtimit dhe demolimit	Mbeturina industriale dhe të rrezikshme	Mbeturina të vëllimshme	Mbeturina tjera
R1	RAJONI I PRISHTINËS	53.1%	38.5%	6.1%	0.7%	1.6%
R2	RAJONI I MITROVICËS	52.7%	29.8%	6.7%	10.3%	0.6%
R3	RAJONII PEJËS	39.1%	50.7%	3.6%	2.3%	4.2%
R4	RAJONI I PRIZRENIT	26.7%	20.7%	12.5%	2.4%	37.7%
R5	RAJONI I FERIZAJT	45.8%	42.8%	6.6%	4.6%	0.2%
R6	RAJONI I GJILANIT	50.3%	37.7%	4.9%	1.7%	5.5%
R7	RAJONI I GJAKOVËS	35.2%	52.3%	4.3%	7.9%	0.3%
KOSOVË		44.6%	38.5%	7.1%	3.7%	6.1%




Figura 1: Deponitë ilegale - të dhënat për vitet 2017 dhe 2019

5.7 Zhvillimet e paparashikuara operative me kosto financiare.

Avaritë e mundshme të makinerive për shkak të amortizimit si dhe kushteve të rënda të ambientit punues, shfaqja e zjarreve, aksidentet e rrjedhjeve të ujërave të zeza etj.

5.8 Kontestet gjyqësore

KMDK është në marrëveshje kontraktuale mes personave juridikë dhe fizikë. Andaj dhe është mundur të kemi konteste kontraktuale për shkak të mos përmbushjës së obligimeve juridike.

5.9 Fatkeqësitë natyrore

Intensiteti i madh i reshjeve të shiut në DS-të, mund të shkaktojë aksidente ekologjike ambientale nga rrjedhjet e ujërave të zeza nga laguna, rrëshqitje të skarpateve dhe fatkeqësi tjera operative, ndikimi i tërmeteve, zjarreve, eksplozimet e mundshme të gazit etj.

6. Menaxhimi i Mbeturinave në BE

Gjenerimi i mbeturinave sipas vendeve të shprehura në kilogram për kokë banori . Për të ilustruar trendet, Tabela 3 tregon mbeturinat për vitet e zgjedhura, duke mbuluar periudhën 1995 deri 2018. Për lexueshmëri më të mirë, Figura 2 përfshin vetëm vitet 2005 dhe 2018. Në Figurën 2, vendet janë renditur në renditje në rritje sipas gjenerimit të mbeturinave në 2018.

Për vitin 2018, totali i gjenerimit të mbeturinave ndryshon mjaft, duke filluar nga 272 kg për kokë banori në Rumani dhe 814 kg për kokë banori në Danimarkë. Ndryshimet pasqyrojnë ndryshimet në modelet e konsumit dhe pasurinë ekonomike, por gjithashtu varen nga mënyra se si grumbullohen dhe menaxhohen mbeturinat.

Nga viti 2004 e tutje, metodologjitë u finalizuan në shumicën e vendeve, kështu që seria kohore e gjenerimit të mbetjeve për vitin 2004 dhe më vonë është më e saktë dhe e qëndrueshme sesa ajo ndërmjet 1995 dhe 2003.

Municipal waste generated, 2005 and 2018




Figura 2: Mbeturinat të gjeneruara nga 2005 dhe 2018 (kg për vend)

MA

Municipal waste generated, in selected years, 1995-2018

(kg per capita)

	1995	2000	2005	2012	2018	Change 2018/1995 (%)
EU-27	467	513	506	488	492	5.4
Belgium	455	471	482	445	411	-9.7
Bulgaria	694	612	588	460	407	-41.4
Czechia	302	335	289	308	351	16.2
Denmark	521	664	736	806	814	56.2
Germany	623	642	565	619	615	-1.3
Estonia	371	453	433	280	405	9.2
Ireland	512	599	731	585
Greece	303	412	442	495
Spain	505	653	588	468	475	-5.9
France	475	514	529	527	527	10.9
Croatia	..	262	336	391	432	..
Italy	454	509	546	504	499	9.9
Cyprus	595	628	688	657
Latvia	264	271	320	323	407	54.2
Lithuania	426	365	387	445	464	8.9
Luxembourg	587	654	672	652	610	3.9
Hungary	460	446	461	402	381	-17.2
Malta	387	533	623	590	640	65.4
Netherlands	539	598	599	549	511	-5.2
Austria	437	580	575	579	579	32.5
Poland	285	320	319	317	329	15.4
Portugal	352	457	452	453	508	44.3
Romania	342	355	383	251	272	-20.5
Slovenia	596	513	494	362	486	-18.5
Slovakia	295	254	273	306	414	40.3
Finland	413	502	478	506	551	33.4
Sweden	386	425	479	454	434	12.4
United Kingdom	498	577	581	477	463	-7.0
Iceland	426	462	516	511
Norway	624	613	426	477	739	18.4
Switzerland	600	656	661	694	703	17.2
Montenegro	494	530	..
North Macedonia	381	301	..
Albania	462	..
Serbia	364	319	..
Turkey	441	465	458	410	424	-3.9
Bosnia and Herzegovina	340	356	..
Kosovo (*)	226	..

(.) data not available

Note: data presented in italic are estimated.

(*) This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of Independence.

Source: Eurostat (online data code: env_wasmun)

eurostat 

Tabela 3: Mbeturinat të gjeneruara, në vitet 1995-2018 (kg për kokë banori)

Qëllimi Afatgjatë i menaxhimit të mbeturinave në BE është zvogëlimi i krijimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre.

Qasja e BE-së në menaxhimin e mbeturinave bazohet në "hierarkinë e mbeturinave" e cila përcakton prioritetet me rastin e hartimit të politikave menaxhuese të mbeturinave në nivel operacional:

- Parandalimin e krijimit të mbetjeve/mbeturinave
- Përgatitjen për ripërdorimin e mbeturinave
- Riciklimin
- Rikuperimin/regjenerimin
- Deponimi



Figura 3: Hierarkia e Menaxhimit të Mbeturinave në BE

7. Menaxhimi i Mbeturinave në Kosovë

Në Republikën e Kosovës nuk ka të dhëna të besueshme dhe të verifikuara për sasinë totale të mbeturinave që gjenerohen në vend brenda vitit. Të dhëna të përafërta mund të arrihen duke u bazuar në sasinë e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare dhe deponitë e tjera dhe në të dhënat nga AMMK-së.

Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare që menaxhohen nga KMDK-ja për vitin 2018 është 299,960.04ton/vit (shih tabelën 1). Në deponitë e tjera sanitare që menaxhohen nga KRM-të, sasia e mbeturinave të deponuara është rreth 117,357.22ton/vit. Kështu, sasia e deponuar e mbeturinave komunale në deponitë sanitare shkon në 417,317.26ton/vit.

Sa i përket sasisë së mbeturinave të deponuara në deponitë tjera jo sanitare si ajo në Istog (Tuçep) janë deponuar 8,287ton/vit mbeturina, kurse prej deponive të tjera në pjesën veriore të Kosovës, nuk kemi të dhëna të raportuara.

Nga këto të dhëna, sasia e përgjithshme e deponuar e mbeturinave në Kosovë është 425,589 ton/vit

Tabela 4. Sasia e mbeturinave të deponuara në Kosovë në vitin 2018

Deponia /Stacioni i transferit	Mbeturinat e deponuara (ton/vit)
Deponia rajonale e Prishtinës (Mirash)	126,351.47
Deponia rajonale e Gjilanit (Velekincë)	65,366.98
Deponia komunale e Podujevës	12,603.60
Deponia rajonale e Prizrenit (Landovicë)	95,637.99
Stacioni i transferit në Ferizaj (është e inkuadruar në raportin për deponim në Gjilan)	
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KMDK-ja:	299,960.04
Deponia rajonale e Mitrovicës (Gërmovë)	62,109.22
Deponia rajonale e Pejës (Sferkë)	49,451.00
Deponia komunale e Dragashit	5,797.00
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KRM-të:	117,357.22
Gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare:	417,317.26
Deponia në Istog (Tuçep)	8,272.00
Deponia në Zveçan*	
Zubin-Potokut (Lluçkarekë)*	
Deponia në Laposaviq*	
Gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë josanitare:	8,272.00
Gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara:	425,589.26

8. Menaxhimi i Mbeturinave – Korniza Ligjore

Synimi i Kosovës është harmonizimi i plotë i legjislacionit vendorë me Acquis të Bashkimit Europian (BE) për sektorin e mbeturinave.

8.1 Korniza Ligjore e BE-së

- Direktiva 2008/98/EC
- Direktiva 91/689/EEC
- Direktiva 75/439/EEC
- Rregullorja (EC) Nr. 1013/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit
- Vendimi 2000/532/EC për Listën e Mbeturinave
- Vendimi i Komisionit (EU) Nr. 2014/955/EU
- Rregullorja e Komisionit (EU) Nr. 1357/2014

8.2 Korniza Ligjore e Kosovës

Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat është ligji kryesor që rregullon sektorin e mbeturinave në Kosovë. Ligji për mbeturinat është lex specialis (ligj special), që nënkupton që kur dy apo më tepër ligje rregullojnë gjendjen faktike të njëjtë apo të ngjashme, ligji që rregullon një qëllim të veçantë (lex specialis) mbizotëron ndaj një ligji që rregullon vetëm çështjet e përgjithshme (lex generalis).

Ligje të tjera që ndikojnë në rregullimin e sektorit të mbeturinave janë :

- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Ligji për Vetëqeverisjen Lokale”);
- Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
- Ligji Nr. 06/L- 016 për Shoqëritë Tregtare
- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës,
- Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat (“Ligji për PPP”);
- Ligji Nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore (“Ligji për Ndhmën Shtetërore”);
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (“Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit”);
- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinorë (“Ligji për Planifikim Hapësinorë”);
- Ligji për Ndërtim,
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor,
- Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,
- Ligji për Ujëra, Ligji për Kimikatet,
- Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes,
- Ligji për Produktet Biocide,
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja,
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe
- Ligji për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimeve dhe Mbeturinave.

9. Orientimi Strategjik

Orientimi i KMDK-së duhet te jetë në realizimin e mandatit të sajë ,që buron nga aktet ligjore dhe nënligjore, për te zbatuar – realizuar dhe adresuar sfidat ekzistuese në pajtim me Strategjinë Nacionale në trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, si dhe mbrojtjen e ambientit.

9.1 GAP Analiza

Sfidat kryesore të identifikuara në Menaxhimin e Deponive Sanitare (DS) të Mbeturinave janë:

- Mos aprovimi i ngritjes reale të tarifës së shërbimit për menaxhim efikas të deponive, tarifa aktuale nuk mbulon shpenzimet operative të trajtimit të mbeturinës për ton.
- Rehabilitimi i Deponisë Sanitare në Mirash.
- Mos mbështetja e mjaftueshme me grante dhe subvencione edhe përkundër ndjeshmërisë së fushës dhe tarifës tejte të ulët.
- Amortizimi i makinerisë ekzistuese si dhe pamjaftueshmëria e makinerisë së nevojshme për trajtimin e mbeturinave.
- Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave si rezultat i konkurrencës së deponive ilegale si dhe nga procesi i ndarjes dhe riciklimit nga operatorët e tjerë.
- Zhvillimet e paparashikuara operative me kosto financiare dhe kontestet gjyqësore.
- Borxhet e vjetra të pa grumbulluara.
- Kosto e lartë e mirëmbajtjes.
- Operatorët Ilegal.
- Mungesa e pajisjeve për analiza të cilësisë ajrit , ujit dhe tokës.

9.2 Pikat e Forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet – SWOT Analiza

Pikat e Forta	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none">✓ Kompani e vetme qendrore për menaxhimin e deponive.✓ Tradite e gjatë e shërbimeve të ofruara , afër 15 vite✓ Ofrues shërbimeve profesional i trajtimit të mbeturinave✓ Vlerësim pozitiv për shërbimeve të ofruara nga klientët✓ Stafi profesional	<ul style="list-style-type: none">✓ Mungesa e licensës✓ Tarifa e ultë ekzistuese✓ Numër i vogël i shërbimeve të ofruara✓ Borxhet e vjetra✓ Mekanizimi i amortizuar✓ Mungesa e ndërtesës Administrative dhe autoparkut✓ Mungesa e elektrifikimit në DS Podujevë dhe ST-Ferizaj

Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Mundësia e zgjerimit në tërë teritorin e Republikës të Kosovës ✓ Arritja e potencialit maksimal në ofrimin e shërbimet për deponimin e mbeturinave . ✓ Rritja e cilësisë dhe efikasite të shërbimeve te ofruara ✓ Zvogëlimi i shpenzimeve ✓ Licensimi, sipas nevojës, për ofrimin e shërbimeve të reja ✓ Modernizimi dhe digjitalizimi i shërbimeve 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fundosja e DS Mirash ✓ Ofrimi i afatit të mbylljes së deponive ✓ Mos caktimi i lokacionit të Deponisë së re ✓ Aksidentet ekologjike ✓ Shfaqja e zjarrëve dhe eksplozimet të mundëshme në DS ✓ Incidentet e mundëshme për shkak të qasjes të përonave të pa autorizuar në DS ✓ Mungesa e investimeve të domosdoshme për ngritjen e cilësisë se shërbimit, modernizimit dhe digjitalizimit ✓ Mos ngritjes së Tarifës

10. Objektivat

Objektivat e Shoqërisë pasqyrojnë implementimin e Strategjive Nacionale për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ruajtjen e Ambientit, dhe janë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. Duke reflektuar mbi nevojat lokale dhe përmbushjen e vizionit dhe misionit të saj.

Objektivat e menaxhimit të mbeturinave sipas SKMM janë pothuajse në të njëjtën vijë me hierarkinë e menaxhimit të mbeturinave të BE-së.



Figura 4: Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave

- Objektivat e KMDK-së SH.A janë:
- Ngritja e kualitetit të shërbimit primar, monitorimit dhe përmirësimit në menaxhimin e qëndrueshëm të deponive.
- Përmirësimi i shërbimeve të Aktiviteteve sekondare.
- Zvogëlimin e rrezikut në DS.
- Ndërtimi i deponive të reja dhe zgjerimi i kapaciteteve pranuese në DS Aktuale.
- TIK në Menaxhimin e deponive.
- Ofrimin e shërbimeve të reja –Aktiviteteve Terciare.
- Rritja e të hyrave dhe kujdesi racional ndaj shpenzimeve.
- Ngritja e Kapaciteteve Teknike dhe kujdesi ndaj aseteve, pajisjeve të punës.

10.1 Përmirësimi i Afarizmit

Përmirësimi i Afarizmit të Shoqërisë ka si qëllim rritjen e të hyrave dhe zvogëlimin e shpenzimeve dhe atë:

- Rritjen e të Hyrave nga shërbimet e ofruara dhe nga shërbimet e reja.
- Duke zvogëluar shpenzimet, dhe duke bërë eliminimin e shpenzimeve të panevojshme dhe shpenzimeve të pajustificuara.

Të gjitha objektivat janë në shërbim të Rritjes së Afarizmit të KMDK-së.

10.2 Ngritja e kualitetit të shërbimit primar, monitorimit dhe përmirësimit në menaxhimin e qëndrueshëm të deponive

- Vendosja e sistemit të ventilimit me ngritjen e nivelit të mbeturinave në sektorë.
- Hapja e kanaleve atmosferike.
- Zgjerimin e sistemit të drenazhimit.
- Vendosja e piezometrave në kontrollin e nivelit të ujërave nëntokësorë.

10.3 Përmirësimi i shërbimeve të Aktiviteteve sekondare

- Planifikimin e sektorëve dhe infrastrukturës përcjellëse për pranimin e mbeturinave afat mesme dhe afat gjate.
- Asgjësimin e mbeturinave të planifikuara në aktivitete sekondare.
- Kontrollin dhe menaxhimin e gazit.

10.4 Zvogëlimin e rrezikut në DS

- Zvogëlimi/eliminimi e Kundërmimit
- Aplikimin e D.D.D. – së.
- Adresimin për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme (Herbicide) në DS Podujevë.
- Zvogëlimi i prezencës së geneve endacakë.
- Ndalim qasje të personave të pa-autorizuar në DS Gjilan.
- Vendosja dhe mirëmbajtja e rrethojave.

- Shenjëzimi i zonave të rrezikut.
- Marrja e masave shëndetësore dhe mbrojtjen në punë.
- Marrja e masave për mirëmbajtjen e shtresave izoluese të bazamentit të DS-ve.

10.5 Ndërtimi i deponive të reja dhe zgjerimi i kapaciteteve pranuese në DS Aktuale

- Ndërtimin e DS të re në Regjionin e Prishtinës.
- Zgjerimi i aneksit të ri në DS Gjilan.
- Zgjerimi i aneksit të ri në DS Prizren.
- Zgjerimi i aneksit të ri në DS Podujevë.
- Rikonstruktimi i Stacionit Transferit në Ferizaj.

10.6 TIK në Menaxhimin e Deponive

- Digjitalizimit i peshoreve dhe blerja e sistemit të navigimit dhe softuerëve.

10.7 Ofrimin e shërbimeve të reja –Aktiviteteve Terciare

- Të fillojë procesi i klasifikimit dhe riciklimit të mbeturinave.

10.8 Rritja e të hyrave dhe kujdesi racional ndaj shpenzimeve

- Aprovimi i tarifës së re nga MEA.
- Zgjerimi i shërbimeve në tërë teritorin e Kosovës.
- Aplikimi i procesit të ndarjes, riciklimit të mbeturinave.
- Kujdesi në racionalizimin e shpenzimeve.

10.9 Ngritja e Kapaciteteve Teknike dhe kujdesi ndaj asetëve, pajisjeve të punës

- Ngritja e Kapaciteteve Teknike.
 - Ndërtimi i autoparkut.
 - Ndërtimi i objektit Administrativë.
 - Blerja e makinerive.
 - Ndërtimin i konstruksionit metalik (Hinkë) në STF.


10.9.1 Kujdesi ndaj asetëve, pajisjeve të punës

- Furnizimi dhe servisimi i pajisjeve kundër zjarrit.
- Furnizimi, mirëmbajtja dhe servisimi i makinerisë.
- Servisimi dhe mirëmbajtja e pompave për riciklimin e ujërave të zeza – Laguna.

11 Ngritja e kapaciteteve njerëzore

Modernizimi dhe rritja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, është e domosdoshme për ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe rritjes së të hyrave, sidomos në aktivitete ku shoqëria ka ekskluzivitetin e ofrimit të atyre shërbimeve

11.1 Organogrami



Struktura Organizative dhe Organogrami i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Statutin e KMDK SH.A dhe Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

11.2 Numri i punëtorëve dhe struktura gjinore

Nr	Struktura	Numri i Punëtorëve
1	Administrata Qendrore	27
1.1	Femra	11
1.2	Meshkuj	16
2	Operativa-Deponitë Sanitare (teknikët, kontrollorët, sigurimi, mirëmbajtësja)	59
2.1	Femra	1
2.2	Meshkuj	58
3	Aftësi te kufizuar	1
Totali i punëtorëve		86

Tabela 5. Numri i Punëtorëve dhe struktura gjinore – KMDK. SH.A




Figura 5: Numri i punëtorëve dhe struktura gjinore

Struktura gjinore në Operativë është e tillë për shkak të natyrës specifike të punës.

1. Rekrutimi i stafit në bazë të rregullores dhe organogramit
2. Ngritja e kapaciteteve njerëzore.

11.3 Planifikimi i trajnimit të stafit

Menaxhmenti do të identifikojë nevojat dhe kërkesat për avancim të mëtutjeshëm profesional të stafit sipas natyrës së punës (si ndryshimi i legjislacionit, zhvillimet teknologjike dhe mekanike etj.) kryesisht të përqendruara në operativë dhe administratë.

11.4 Rekrutimi i stafit

Plotësimi i vendeve të lira të punës në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Statutit të Kompanisë dhe Rregulloret e Brendshme.

Gjithashtu rritja e numrit të shërbimeve dhe e cilësisë së shërbimeve, do të kërkojë rritjen e kapaciteteve njerëzore.

Gjatë vitit 2021 bazuar në Rregulloren e Brendshme dhe Planin e Biznesit janë të parapara të plotësohen këto pozita të cilat kanë qenë të aprovuara edhe me Planin e Biznesit të vitit 2019 si vijon; Asistent i KE-së, Zyrtar i prokurimit, Zyrtar për përkthim në gjuhën angleze, Vozitës i administratës, Menaxher i deponisë sanitare në Mirash, Operator teknik i sektorëve dhe urëmatës (2) pozita, Punëtor për hortikulturë (2) pozita.

12 . Kapaciteti dhe mundësitë potenciale për rritjen e biznesit

KMDK SHA, ka hapësira të mjaftueshme fizike si dhe potenciale kadrovike për ti futur në zbatim dhe shfrytëzim të aktiviteteve për zgjerime biznesore në vitet e ardhshme (2021-2023), duke u orientuar në aktivitetet e reja siç janë: ndarja, selektimi dhe riciklimi i mbeturinave përmes të cilave do të rritej afarizmi i kompanisë dhe zvogëlimi i ndotjes së mjedisit.

Tabela 6. Sasia e mbeturinave nga KRM-të dhe klientët privat, për periudhën 2021, 2022 dhe 2023

SASIA E MBETURINAVE SANITARE E PLANIFIKUARA NË TONËLATË				
Deponia Sanitare	2020	2021	2022	2023
Mirashi (KRM)	136641	143446	152770	157353
Mirashi (Privat)	17093	17944	19111	19684

Landovicë (KRM)	94619	99331	105788	108961
Landovicë (Privat)	17600	18476	19677	20268
Velekincë (KRM)	44055	46249	49255	50733
Velekincë (Privat)	2050	2152	2292	2361
Dumnicë (KRM)	15024	15772	16797	17301
Dumnicë (Privat)	1520	1595	1699	1750
Gërlicë (KRM)	20651	21679	23089	23781
Gërlicë (Privat)	5075	5328	5674	5844
TOTALI në TON	354,328	371,972	396,152	408,036

* Sasia e mbeturinave për vitin 2021 është planifikuar të ketë një rritje prej 4.98% nga planifikimi i vitit 2020, ndërsa për vitet 2022 rritje prej 6.5% dhe 2023 rritje prej 3%.

Tabela 7. Kalkulimet analitike sipas deponive sanitare dhe Stacionit të transferit në Gerlicë-Ferizaj në sasi (ton) bazuar në 9 mujorin e planifikimit dhe realizimit nga viti 2020.

Deponia Sanitare	Planifikimi	Realizimi	Diferenca	%	Indexi
	1-9/2020	2020			
Mirashi (KRM)	106087	101215	-4872	0.95	-0.05
Mirashi (Privat)	11820	11405	-415	0.96	-0.04
Landovicë (KRM)	72964	69211	-3753	0.95	-0.05
Landovicë (Privat)	11200	8336	-2864	0.74	-0.26
Velekincë (KRM)	34041	30166	-3875	0.89	-0.11
Velekincë (Privat)	1238	344	-894	0.28	-0.72
Dumnicë (KRM)	13268	11344	-1924	0.85	-0.15
Dumnicë (Privat)	1336	533	-803	0.40	-0.60
Gërlicë (KRM)	17487	16196	-1291	0.93	-0.07
Gërlicë (Privat)	3806	3288	-518	0.86	-0.14
TOTALI	273247	252038	-21209	0.92	-0.08

* Sasia e mbeturinave për mbetjet shtazore edhe mbeturinat e asgjësuar në tonelata për vitin 2021 është planifikuar një rritje prej 11.77% ndërsa për vitet 2022 dhe 2023 nuk planifikohet rritje kjo kategori për shkak se pritet startimi me punë i impiantit për trajtimin e mbetjeve shtazore.

KMDK synon të mbaj të konsoliduar shkallën e inkasimit përmes:

- Marrjes së masave administrative
- Ri programimi i borxheve sipas kornizës ligjore
- Përmes inicimit të padive nëpër gjykatat kompetente
- Përmes mundësive tjera ligjore.

13 Plani i analizave financiare

Kompania synon që të mbulojë kostot operative në përjashtim të amortizimit, me të ardhura nga të hyrat vetanake (shih projeksionet financiare në Tabela nr.10.1)

Raporti i të hyrave në euro nga mbeturinat e amvisërisë (komunale) për vitin 2017, 2018 dhe 2019

Tabela nr.8

PASQYRA E REALIZIMIT TE TË HYRAVE PËR VITET 2017-2018-2019	Realizimi i të hyrave	Realizimi i të hyrave	Realizimi i të hyrave
	për vitin 2017	për vitin 2018	për vitin 2019
	Euro (€)	Euro (€)	Euro (€)
I. TE HYRAT			
1. Të hyrat nga KRM-të (mbeturinë e amvisrise)	1,305,152	1,381,997	1,568,451

KAA

2. Të hyrat nga klientët privat (mbeturinë e amvisrise)	176,886	205,721	215,588
Totali i të hyrave nga pozicioni (1 + 2)	1,482,038	1,587,718	1,784,039

Tabela 9 Sasia e mbeturinave nga KRM-të dhe klientët privat, për periudhën 2017, 2018 dhe 2019

SASIA E MBETURINAVE SANITARE E PRANUARA NË TONËLATË

SASIA E PRANUAR NE TON	2017	2018	2019
I KRM-të mbeturina të amvisrisë	245,791	260,263	295,377
II. Bizneset private mbeturina	33,312	38,743	40,600
III. Totali (I+II) në Ton	279,103	299,006	335,977

Tabela 10. Pasqyra e planifikimit të të hyrave, shpenzimeve dhe amortizimit për vitin 2020.

PASQYRA E PLANIFIKIMIT TE TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN 2020	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve
	për vitin 2020
	Euro (€)
I. TE HYRAT	
1. Të hyrat nga KRM-të (mbeturine sanitare) ¹	1,651,359
2. Të hyrat nga klientët privat (mbeturine sanitare)	230,127
A. Totali i të hyrave nga pozicioni (1 + 2)	1,881,486

¹Totali i të hyrave operative nga veprimtaria primare për vitin 2020 planifikohet të ketë rritje prej 9% .

MA

3. Të hyrat nga mbetjet shtazore dhe mbeturinat e asgjësuara ²	88,640
B. Totali i të hyrave operative (3)	88,640
C. Totali i te hyrave (A+B)	1,970,126
1. Inkasimi nga Marrëveshjet e ri programimeve të borgjeve	392,418
D. Totali i të hyrave të (C+1)	2,362,544
II. SHPENZIMET	
1. Pagat bazë	653,550
2. Përvoja e punës sipas koeficientit 0.05% për vit pune	32,960
3. Shujta	52,736
4. Mirënjohje, shpërblime, bonuse dhe stimulime	27,485
5. Kontributet pensionale 5% nga Punëdhënësi	38,336
6. Kontributet Shëndetësore 3.5 % nga Punëdhënësi	/
7. Trajtimi i mbeturinave-deponimi, mirëmbajtja dhe infrastruktura	200,500
8. Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së makinerisë*	140,500
9. Furnizim dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit	12,500
10. Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtje të automjeteve	7,500
11. Shpenzimet për derivate të naftës	163,000
12. Shpenzimet për vajra	21,000
13. Shpenzimet për filtra	16,950
14. Shpenzimet administrative.*	124,000
15. Shërbimet e konsulencës, trajnimet, udhëtimet	35,500
16. Shpenzimet e reprezentacionit dhe përfaqësimit	7,400
17. Të pa parashikuara (administrative, ndëshkime, gjyqësorë, operative, raste emergjente dhe fatkeqësi)	33,000

² Të hyrat nga mbetjet shtazore edhe mbeturinat e asgjësuara, për vitin 2020 planifikohet të ketë rritje prej 14.4% .

MA

18. Marrja e veturave me Qera	960
19. Shpenzimet për kryerjen e analizave të ujit në Lagunat e DS-ve	/
20. Servisimi dhe mirëmbajtja e peshoreve egzistuese	3,000
E. Totali i shpenzimeve operative (1 deri 20)	1,570,877
III. Fitimi operativ para Zhvlerësimit (C-E)	399,249
IV. Amortizimi-Shpenzimet e zhvlerësimit	-781,200
V. Fitimi/Humbja para të hyrave jo operative (III-IV)	-381,951
VI. Të hyrat jo operative (Të hyrat nga Donacionet e shtyra)	375,592
VII. Të hyrat nga Grandët e shtyra	8,489
VIII. Të hyrat nga njohja e Rivlerësimit të deponive	/
IX. Të hyrat jo operative-Subvencion	/
VIII. Fitimi/Humbja e vitit para tatimit: (V-VI-VII-VIII-IX)	2,130

Tabela 11 Pasqyra e planifikimit të të hyrave, shpenzimeve dhe amortizimit (Shpenzimet e Zhvlerësimit) për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

PASQYRA E PLANIFIKIMIT TE TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITET 2021-2022-2023	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve
	për vitin 2021	për vitin 2022	për vitin 2023
	Euro (€)	Euro (€)	Euro (€)
I. TE HYRAT			

1. Të hyrat nga KRM-të (<i>mbeturine amvisrise</i>) ³	1,733,593	1,846,282	1,901,665
2. Të hyrat nga klientët privat (<i>mbeturine amvisrise</i>) ⁴	241,579	257,285	265,006
A. Totali i të hyrave nga pozicioni (1 + 2)	1,975,172	2,103,567	2,166,671
3. Të hyrat nga mbetjet shtazore edhe mbeturinat e asgjësuar ⁵	99,070	99,070	99,070
B. Totali i të hyrave operative nga mbetejet shtazore (3)	99,070	99,070	99,070
C. Totali i te hyrave (A+B)	2,074,242	2,202,637	2,265,741
1. Inkasimi nga Marrëveshjet e riprogramimeve të borgjeve	270,910	111,130	
D. Totali i të hyrave dhe inkasimi nga riprogramimi i borxhit (C+1)	2,345,152	2,313,767	2,265,741
II. SHPENZIMET			
1. Pagat bazë	719,905	719,905	719,905
2. Përvoja e punës sipas koeficientit 0.05% për vit pune	36,560	39,500	42,500
3. Shujta	68,970	68,970	68,970
4. Mirënjohje, shpërblime, bonuse dhe stimulime	22,000	22,000	22,000
5. Kontributet pensionale 5% nga Punëdhënësi	42,372	42,518	42,668

³ Totali i të hyrave operative nga veprimtaria primare për KRM-te, për vitin 2021 planifikohet rritje për 4.98%, për vitin 2022 rritje për 6.5% dhe për vitin 2023 planifikohet të ketë rritje prej 3%.

⁴ Totali i të hyrave operative nga veprimtaria primare për bizneset private, , për vitin 2021 planifikohet rritje për 4.98% për vitin 2022 rritje për 6.5% dhe për vitin 2023 planifikohet të ketë rritje prej 3%.

⁵ Te hyrat nga mbetjet shtazore dhe mbeturinat e asgjësuar, për vitin 2021 planifikohet një rritje për 11.77% ndërsa për vitin 2022 dhe 2023 pa rritje .

6. Kontributet Shëndetësore 3.5 % nga Punëdhënësi ,vetem per 6 mujorin e dytë 2021	14,830	29,763	29,868
7. Trajtimi i mbeturinave-deponimi, mirëmbajtja dhe infrastruktura	208,474	214,755	221,198
8. Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së makinerisë*	140,000	148,835	153,300
9. Furnizim dhe servisimi i aparateve kunder zjarrit	12,875	12,875	13,261
10. Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes të automjeteve	7,725	8,110	8,677
11. Shpenzimet për derivate të naftës	190,000	236,900	244,007
12. Shpenzimet për vajra	30,000	36,559	38,164
13. Shpenzimet filtra	16,950	16,950	16,950
14. Shpenzimet administrative.	143,230	148,629	154,976
15. Shërbimet e konsulencës, trajnimet, udhëtimet ,e tjera	25,000	46,629	48,059
16. Shpenzimet e Reprerentacionit dhe përfaqësimit	7,400	10,712	11,033
17. Të pa parashikuara (administrative, ndëshkime, gjyqësorë, operative, raste emergjente dhe fatkeqësi)	20,000	77,250	79,568
18. Marrja e veturave me qera	500	800	600
19. Shpenzimet për kryerjen e analizave të ujit në Lagunat e DS-ve	15,000	15,000	20,000
20. Servisimi dhe mirëmbajtja e peshoreve egzistuese	4,000		
E. Totali i shpenzimeve operative (1 deri 20)	1,725,791	1,896,660	1,935,704
III. Fitimi operativ para zhvlerësimit (C-E)	348,451	305,977	330,037

M2A

IV. Amortizimi-shpenzimet e zhvlerësimit	-409,290	-330,550	-345,600
V. Fitimi/humbja para të hyrave jo operative (III-IV)	-60,839	-24,573	-15,563
VI. Të hyrat jo operative	65,958	34,758	34,758
VII. Fitimi/humbja e vitit para tatimit: (V-VI)	5,119	10,185	19,195

14 . Deklarata dhe analiza e të hyrave

Në periudhën 2021 – 2023, KMDK SHA planifikon që të realizojë këto të hyra si në tabelën 12

Tabela 12. Plani i Të hyrat nga mbeturinat në ton

TË HYRAT E PLANIFIKUARA NGA MBETURINAT SANITARE NË TON			
Deponia Sanitare	2021	2022	2023
Mirashi (KRM)	143446	152770	157353
Mirashi (Privat)	17944	19111	19684
Landovice (KRM)	99331	105788	108961
Landovice (Privat)	18476	19677	20268
Velekince (KRM)	46249	49255	50733
Velekince (Privat)	2152	2292	2361

Dumnice (KRM)	15772	16797	17301
Dumnice (Privat)	1595	1699	1750
Gerlice (KRM)	21679	23089	23781
Gerlice (Privat)	5328	5674	5844
TOTALI në TON	371,972	396,152	408,036

15. PLANI I INVESTIMEVE

Plani i investimeve për periudhën 2021-2023, parasheh: punët, furnizimet, riparimet e infrastukturës dhe makinerisë së rëndë, sipas projekteve të paraqitura në tabelat më poshtë.

Këto projekte të planifikuara do të realizohen konform inkasimit dhe arkëtimit të borxheve, si dhe në rast të përkrahjes -financimit nga Aksionari dhe donatorët,(shih tabelën nr.13)

Tabela 13. PROJEKTET INVESTIVE TË PROPOZUARA PER VITËT 2021-2023

Nr.	AKTIVITETET INVESTIVE	Planifikimi	Planifikimi	Planifikimi
		2021	2022	2023
1	Furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtja e makinerisë	126,000	132,300	137,600
2	Blerje e makinerisë	220,000	100,000	200,000

3	Vendosja e sistemit të navigimit/kamerat në 3 DS si dhe GPRS në makineri dhe veturat	8,000	0	0
4	Digjitalizimi i peshoreve në DS Dumnice & STF mirëmbajtja	0	9,800	0
5	Blerje e automjeteve(veturë)	35,000	0	25,000
6	Investimet në Riparim dhe zgjerimin e Infrastrukturës në DS dhe STF *	569,916	300,424	136,082
7	Riparimi i llagunës-Gjilan	36,000	0	0
8	Furnizim me kompresor dhe vegla pune	2,480	2,480	980
9	Teknologji Informative	5,000	2,000	2,000
10	Invertar për zyre	2,000	950	950
11	Furnzim me Port Lëvizeze, (Laure dhe Shiber)	980	4,500	0
Totali i investimeve (1 deri 11)		1,005,376	552,245	502,612

* Projektet investive mund të mos realizohen nëse nuk kemi ngritje tarifës

* Invenstimet në Riparimin dhe zgjerimin e infrastrukturës në DS dhe STF përfshinë; Riparimi i llagunës-Gjilan, Furnizimi, vendosja dhe mirëmbajtja e sistemit të ventilimit në DS, Riparimin e kontinierit shërbimit në DS PR, Instalimi i rrymës në DS Podujevë dhe ST Ferizaj, Vendosja e rrethojës në DS Podujevë, Prizren, Gjilan dhe STF-e, Vendosja e shenjave sinjalizuese në të gjitha DS, Vendosjen e murit mbrojtës , dhe drenazhimin në STF për mbrojtje të pllato asfaltit, Ndërtimin e konstruksionit metalik në formë Hinke për shkarkimin e mbeturinave në STF, Meremitimi i Nyjeve Sanitare nëpë DS etj.

16. STRUKTURA E BUXHETIT

Planifikimi i pagave dhe shpenzimeve	Për vitin 2021	Për vitin 2022	Për vitin 2023
1. Pagat bazë	719,905	719,905	719,905
2. Kompenzimet dhe meditet	127,530	130,470	133,470
Paga BRUTO (1 + 2)	847,435	850,375	853,375

MZA

Kontributet pensionale 5% nga Punëdhënësi	42,372	42,519	42,668
Kontributet Shëndetësore 3.5 % nga Punëdhënësi	14,830	29,763	29,868
Mallra dhe shërbime	753,254	838,612	870,533
Të pa parashikuara (administrative, ndëshkime gjyqësore, operative, raste emergjente dhe fatkeqësi)	20,000	77,250	79,568
Shpenzime tjera	47,900	58,141	59,692
Investime me burime të brendshme	619,361	417,107	330,037
Investime me burime të jashtme	386,015	135,138	172,575

Tabela 14. Tabela e strukturës buxhetit

MFA

Struktura e Buxhetit




Figura 6. Tabela e strukturës buxhetit

MBA

Nr.	INVESTIMET KAPITALE TE SYNUARA*	Planifikimi 2021-2023 (€)	Burimet e financimit
1	Ndërtimi i DS së re në Regjionin e Prishtinës	12,707,894	KFW&Qeveria,
2	Zgjerimi i DS në Prizren- Faza II	7,164,547	KFW&Qeveria,
3	Zgjerimi i DS në Gjilan – Faza II	8,231,139	KFW&Qeveria,
4	Rehabilitimi i DS në Podujeve	1,755,164	KFW&Qeveria,
5	Rikonstrukcioni dhe zgjerimi i ST në Ferizaj	1,493,512	KFW&Qeveria,
Totali i aktiviteteve investive (1 deri 5)		31,352,256	KFW&Qeveria,

*Tabela 15. Investimet kapitale të synuara parapara me bashkëfinancimet e jashtme**

*Projektet e renditura nga 1 deri 5 janë pjesë e raportit të Studimit të Fizibilitetit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta në Kosovë nga Banka Gjermane.

*Në rast se nuk realizohet projekti atëherë zgjidhja alternative sipas KMDK-së do të jetë ndërtimi i një Deponie Qendrore në Republikën e Kosovës për pranimin e mbeturinave komunale.

